

MARREVESHJE

PER : BASHKIMIN ME PERTHITHJE TE SHOQERIVE

“Imperial Group” sh.a dhe “Imperial C. Construction” sh.p.k

Tirane me, 30 Korrik 2024

Shoqeria “Imperial Group” sh.a eshte regjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 24/12/2010, me seli Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1,Nr.Pasurie 2/144-N2.

Shoqeria “Imperial Group” sh.a me NIPT-in L02424005D, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 1.422.427.659,00 leke me kontribut te aksionereve: 56% Pellumb Gjoka, 22% Kolë Gjoka dhe 22% Alida Gjoka. Administrator i shoqerise eshte Gentjan Haka.

Shoqeria “Imperial C. Construction” sh.p.k eshte rregjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me daten 15/07/2016, me seli Tirane Tirane TIRANE Rruga "Jeronim De Rada", Nr 43, Nr pasurie 6/348+1-43, Zona Kadastrale 8150

Shoqeria “Imperial C. Construction” sh.p.k me NIPT-in L61915015H, aktualisht ka nje kapital themeltar prej 100.000 leke me kontribut 100% te Ortakut te Vetem Pellumb Gjoka Administrator i shoqerise eshte Gentjan Haka.

Pas bisedimesh paraprake organet vendimarrrese te dy shoqerive kane rene dakort per bashkimin e shoqerive, ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” te nenit 215 pika 1.

Ne zbatim te nenit 216 pika 1 te ligjit 9901 date 14.04.2008 per “Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” hartohet ky projek per bashkimi e shoqerive me keto kushte :

1.Bashkimi do te kryhet ne formen e perthithjes ku shoqeria tregtare “Imperial Group” Sh.a do te jete shoqeria perthithese dhe shoqeria tregtare “Imperial C. Construction” shpk do te jete shoqeria e perthithur.

2.Raporti kembimit te Kuotave do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 “Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare” neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do te jete mbi bazen e vleres ne leke qe ze shuma e kapitalit themeltar te seciles shoqeri qe merr pjese ne procesin e perthithjes ndaj kapitalit themeltar te shoqerise se re pas perthithjes e rrjedhimisht dhe secili ortak ne raport me pjesemarrjen ne kapitalit themeltar te shoqerise qe merr pjese ne procesin e perthithjes e me pas me raportin e secilit ortak ne kapitalin themeltar te shoqerise se re pas perthithjes.

3.Kushtet e ndarjes se kuotave te shoqerise pas bashkimit me perthithje do te jete ne zbatim te ligjit 129/2014 date 02.10.2014 ne ndryshim te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" neni 68 pika 2 ku çdo ortak do te kete nje kuote, ndersa pjesemarrja ne kapitalin themeltar te shoqerise do jete mbi bazen e raportit qe ze secili kapital themeltar i shoqerive te veçanta ndaj totalit te kapitalit themeltar ne shoqerine e re.

4.Data, duke u nisur nga e cila zotëruesit e kuotave (ortaket e shoqerise se re pas perthithjes) kanë të drejtë të marrin pjesë në ndarjen e fitimit do te jete 01.01.2019.

5.Data, duke nisur nga e cila veprimet e shoqërisë "Imperial C. Construction" shpk që përthithet do të trajtohen nga pikëpamja kontabël si veprime të shoqërisë përthithëse "Imperial Group" sh.a do te jete 31.03.2023.

6.Të drejtat që shoqëria përthithëse "Imperial Group" Sh.a u njeh zotëruesve të kuotave (ortakeve), jane ato qe percaktohen ne statutin e shoqerise perthithese "Imperial Group" Sh.a. dhe ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

7.Perparesite apo kufizimet e Administratorit te shoqerise se re pas perthithjes do te jene ato qe i njeh statuti i shoqerise perthithese "Imperial Group" Sh.a. dhe ne zbatim te ligjit 9901 date 14.04.2008 per "Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare".

8.Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te punesuarve te te dyja shoqerive qe marrin pjese ne procesin e perthithjes.

9.Pasojat e bashkimit nuk do te kene asnje influence ndaj te treteve te seciles shoqeri para perthithjes.

10.Aksioneret e shoqerise se re do te jene Pellumb Gjoka, Kolë Gjoka dhe Alida Gjoka

11.Emri i shoqerise se krijuar nga bashkimi do te jete "Imperial Group" sh.a

12.Selia e shoqerise se re do jete: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake Nr.2, Rruga Luigj Gurakuqi, Pallati Mig-Mar, Pallati 12 katesh , Kati 1,Nr.Pasurie 2/144-N2.

13.Statuti i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i shoqerise "Imperial Group" sh.a para perthithjes

14.Objekti veprimtarise i shoqerise se re pas perthithjes do te jete ai i dy shoqerive para perthithjes

15.Administratore e shoqerise se krijuar nga bashkimi do jete Gentjan Haka me nje mandat 5 vjeçar.

16.Baza e nisjes per bashkimin do te jene treguesit e bilancit te dates 31.03.2023, ndersa aktiviteti i vitit 2023 do te jete i perbashket me sistemimet e nevojeshme sipas Standarteve Kombetare te Kontabilitetit te permiresuara ne zbatim te ligjit 25/2018 dt. 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

17.Kapitali aksioner dhe Perqindjet (te trajtuara ne piken 2 dhe 3 si me siper) e secilit aksioner ne kapitalin e ri themeltar te krijuar nga bashkimi do te percaktohen pas paraqitjes se aktit te ekspertimit nga Audituese "Etleva Gani".

19. Kapitali i regjistruar i shoqerise dhe Aksionet e themeluesve ne te

Kapital i regjistruar i shoqerise eshte 1,422,527,659 leke, i ndare ne aksione te zakonshme me vlere nominale 372,682.12 leke secili.

Numri i pergjithshem i aksioneve eshte 3817 aksione.

Vlera e kapitalit të shlyer 1,422,527,659 leke.

Aksionet e themeluesve ne kapitalin e shoqerise jane ne perputhje me kontributin e tyre te meposhtem:

a.Aksionari themelues Pellumb Gjoka; lloji i kontributit ne para 307,328,000 leke dhe ne natyre 489,287,489.04 leke; numri i aksioneve me te drejte vote 2137, perqindja e pjesemarrjes 56%, vlere e kontributit ne total 796,615,489.04 leke.




b.Aksionari themelues Kole Gjoka; lloji i kontributit ne para 120,736,000 leke dhe ne natyre 192,220,084.98 leke; numri i aksioneve me te drejte vote 840, perqindja e pjesemarrjes 22%, vlera e kontributit ne total 312,956,084.98 leke.

c.Aksionari themelues Alida Gjoka; lloji i kontributit ne para 120,736,000 leke dhe ne natyre 192,220,084.98 leke; numri i aksioneve me te drejte vote 840, perqindja e pjesemarrjes 22%, vlera e kontributit ne total 312,956,084.98 leke.

18.Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise “Imperial C. Construction” shpk do t’i kalojne shoqerise “Imperial Group” sh.a.

Per Shoqerine “Imperial Group” sh.a

Perfaqesuesi Ligjor



Per Shoqerine “Imperial C. Construction” shpk

Perfaqesuesi Ligjor

